

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Krahasimi - Alabbari rrëmben Maldivet/ Kompleks turistik 20 miliardë usd, por shteti përfiton shumë më t epër se në Shqipëri
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918873/alabbari-rremben-maldivet-kompleks-turistik-20-miliarde-usd-por-shteti-perfiton-shume-me-teper-se-ne-shqiperi/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 12:01:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 11:03:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	10dfc1211d547b09bc0d01990c506855533394fa6dfc4c2d7ffc0d2560dd57d4
TEKSTI	65e99f26d657a3f07b08cf568056990000713436341e2886c931a513ab8a46ad
PAMJA	1a8590cf576bc8783899ae601ff4b031f3ee4c6405edc75846977e7a113da127

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	37d304488a115ddb1d26b2a0026685516d0f8a7ac65498c2f27ca0b00b018c6c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ff908387fa0a76615844b1eb2f3b6d25afb991cdfafb8197b5cbb8a7a203d8c9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/37d304488a115ddb1d26b2a0026685516d0f8a7ac65498c2f27ca0b00b018c6c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës**më të lexuarat**VIDEO-‘Janë 3 orë përgjime’/ Ahmetaj:
Javën tjetër do publikojmë edhe dy
pasazhe të tjera. Monaco ...Protesta e 53-të në Divjakë/ Banorët
vijnë qëndresën kundër propozimit të
PS për bashkimin me LushnjënMashtrimi me shëndetësinë falas:
Shqipëria e dyta në Europë për koston e
lartëVIDEO-‘Hajde të tregoj unë ty’/
Përplasja me Ramën në avion, i riu: Më
kapi për qafe dhe më tha ‘të zhdruk’Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në
pikëpyetje sigurinë kombëtare të
Shqipërisë‘S’ka normalitet për situatën ku
ndodhemi’, Këlliçi: Të gjithë e kanë
pranuar skandalin e Roni Yeffet, Rama
jo!**Alabbari rrëmben Maldivet/ Kompleks
turistik 20 miliardë usd, por shteti përfiton
shumë më tepër se në Shqipëri**

13:03, 24/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Kompania Eagle Hills, e cila po ndërton projektin problematik në Portin e Durrës, nënshkroi dy ditë më parë një kontratë me qeverinë e Maldivëve për të ndërtuar një kompleks turistik me vlerë 20 miliardë dollarë.

Marrëveshja i jep kompanisë Eagle Hills të Alabbarit një sipërfaqe toke prej mbi 500 hektarësh në zonën e quajtur Rasmale, një ishull i krijuar artificialisht përmes fitimit të tokës nga deti, ose argjilimit siç njihet ndryshe.

**Ishulli Rasmale, ku do te ndertohet projekti**

Qeveria e Maldivëve do të vërë në dispozicion tokën me qira 99 vjet. Në këmbimit Eagle Hills e Alabbarit do të investojë 12-20 miliardë dollarë për ndërtimin e kompleksit turistik, i cili parashikohet të ketë 65 mijë njësi banimi, hotele, shkolla dhe facilitete të tjera.

Jo favore si Shqipëria

Marrëveshja parashikon se qeveria e Maldivëve do të marrë një taksë 10 për qind mbi xhiron e kompanisë si dhe një tarifë fikse 4 për qind për çdo pronë të shitur,

plus rishitjen e tyre.

Paralelisht kompania nuk përfiton asnjë lehtësim nga taksat e tjera që zbatohen në Maldive, ndryshe nga Shqipëria ku ajo u përjashtua thuajse nga të gjitha taksat.

Përtej kësaj, si pjesë e marrëveshjes Eagle Hills është e detyruar të ndërtojë 5 mijë banesa sociale në një vend tjetër jashtë projektit, të cilat do të përdoren për të strehuar familjet e Maldiveve.

Krahasimi mes dy marrëveshjeve tregon se ajo e Shqipërisë është dukshëm më pak përfituese. Në Maldive, rreziku është i investitorit. Qeveria e Maldiveve luan rolin e "pronarit të tokës". Pavarësisht nëse Alabbar fiton apo humbet para nga resortet, shteti merr 10% cash për çdo metër katror të shitur.

Karakteristika	Skema në Maldive (Ras Malé)	Skema në Shqipëri (Porti i Durrësit)
Modeli i Përfitimit	Përqindje direkte mbi xhiron (shitjet): Shteti merr para për çdo transaksion pa pritur nëse kompania del apo jo me fitim neto.	Pjesëmarrje në fitim (Divident): Shteti nuk merr para nga xhironja, por do të presë ndarjen e fitimit neto në fund të vitit, nëse kompania rezulton fitimprurëse.
Pjesa e Shtetit	10% nga të gjitha shitjet tregtare dhe 4% tarifë fikse mbi çdo rishitje pronash.	33% e aksioneve të kompanisë së përbashkët "Durrës Marina".
Kontributi i Shtetit	Toka e argjiluar (e krijuar): Shteti jep të drejtën e qirasë për 99 vite mbi tokën e re të fituar nga deti.	Toka publike ekzistuese: Shteti shqiptar fali dhe transferoi mbi 818,000 m ² tokë të portit ekzistues në funksion të projektit.
Taksat dhe Lehtësitë	Nuk ka lëshime tatimore (no tax concessions); kompania i nënshtrohet rregullave të vendit.	Përjashtim masiv nga taksat: Alabbar u përjashtua nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (4%-8%) dhe taksa e strehimit social (3%).
Banesat Sociale	Kompania Eagle Hills është e detyruar të ndërtojë 5,000 banesa sociale falas për vendasit.	Nuk ka detyrim për ndërtim banesat sociale, pasi kompania u përjashtua ligjërisht nga ky kontribut.

Krahasimi mes perfitimeve te shtetit ne Shqiperi dhe Maldive

Në Shqipëri, shteti ndan rrezikun. Duke qenë aksionar me 33%, Shqipëria fiton vetëm nëse apartamentet shiten shpenjtë dhe kompania menaxhohet pa fryrje kostosh.

Përjashtimi nga taksat e zakonshme që llogariten rreth 10% e vlerës së projektit i hoqi arkës së shtetit para të sigurta në shkëmbim të një dividendi të pasigurt në të ardhmen.

Ministri i Infrastrukturës së Maldiveve deklaroi se qeveria pret të arkëtojë 10 deri në 11 miliardë dollarë të ardhura direkte nga projekti. Në Shqipëri, do të arkëtojë vetëm 33 për qind të fitimit, gjithmonë nëse projekti do të ecë mirë dhe nëse Eagle Hills, e cila zotëron llogaritë e tij, do ta nxjerrë bilancin me fitim.

Kritika të ashpra edhe në Maldive



Pavarësisht kushteve më të favorshme se në Shqipëri, marrëveshja në Maldive ka shkatuar reagime dhe kundërshti të forta nga opozita dhe qytetarët. Kritikët kundërshtuan mungesën e transparencës dhe potencialin për pronësi të huaja.

Lagunat masive mbi të cilat ndodhen vendpushimet e integruara Rasmalé dhe Crossroads janë "asetet më të vlefshme" të vendit që qeveritë nuk duhet t'i japin me qira për periudha të gjata, argumentoi deputeti i opozitës Ahmed Shamheed, duke vlerësuar se toka e rikuperuar vlenë midis 10 dhe 17 miliardë dollarë

‘Garancia e plotë’ e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin

‘Rama, një bandit që vjedh i pashqetësuar’, Blushi: ‘KAYO’ e rivërtetoi se shteti është mafie sot!

Nata e 6 në shesh kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së/ Protestës i bashkohet edhe Përparim Rama

amerikanë dhe ajo po i jepej Alabbarit.

Ndërsa qarkullonin pretendimet se Rasmalë ishte dorëzuar "për 99 vjet plus rivendosje të pakufizuar", Ministri i Financave Hassan Zareer doli në televizionin shtetëror për të këmbëngulur se "asnjë inç" tokë nuk do të shitej.

Rekordet e dyshimta të Eagle Hills

Bilanci i Eagle Hills jashtë vendit është i përzier. Projekti "Belgrade ëaterfront" – në pronësi të Eagle Hills (68%) dhe shtetit serb (32%) – ka përfunduar ndërtimin e 34 prej 60 godinave të planifikuara, sipas faqes së internetit të projektit.

Megjithatë, në shkurt të vitit 2025, qeveria hungareze njoftoi se Eagle Hills nuk do të vazhdonte me një projekt të madh të quajtur "Grand Budapest".

Shqetësime të ngjashme lidhur me kushtet jo transparente dhe miratimet e përshtetura kanë shoqëruar projektet e "Eagle Hills" në Shqipëri dhe në Gjeorgji.

Në Durrës, projekti i Alabbar është përballur me kritikë të shumta, për shkak të kushteve të disfavorshme për shtetin, por edhe për cilësinë e ndërtimeve. Dy prej godinave të para që u ndërtuan karabina janë fundosur më dhjetra centimetra, ndërkohë që Eagle Hills thuhet se ka ndaluar totalisht punimet, duke vazhduar me ritme minimale./**Kapitali**

© SYRI.net

Lexo edhe:



Berisha: Hyseni ka zbatuar çdo porosi të Ramës! Ergys Agasi është mafiozi më i rrezikshëm i Europës



VIDEO/ Deputetja që i servilosej Ramës blen këpucë online në seancë parlamentare



Revolta kundër Ramës/ Policia shoqëron 17 protestues

TË NGJASHME



Boçi: Vlorë Hyseni nuk ra nga qielli, Rama duhet të vijë këtu me dorëheqjen në dorë



'Vlorë Hyseni dhe Ergys Agasi, pupacët e Edi Ramës?' – Balliu: Përgjegjësi është vetëm një: Edi Rama



'Peleshi shantazhohet nga Agasi me filmime' / Blushi: Po kërcënohesh, jep dorëheqjen



Topalli-Peleshi: Je numri 2 i Republikës dhe nuk flet një fjalë për ish-shëfën e SHISH, të sugjeroj dorëheqjen



Elbasanin e fitoi Suel Çela, Durrësin Poja, Fierin paratë e Ballukut! Alizoti - Peleshi: Nëse ke këllqë thirr Ramën këtu



Reflektimet e Diellës mbi dosjen rozë të SPAK-ut



'Shtetit shqiptar i kanë fikur radarët, sot ka rënë de facto' / Korreshi: Rama ka qeverisur me krimin

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.